

Vendim nr. 145 datë 25.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|-----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryesuese |
| Sandër Beci, | Anëtar |
| Illir Toska, | Anëtar |

në datën 25.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GEG GEGA

OBJEKTI: Përfitimi nga ligji nr. 33/2024, datë 04.04.2024 “Për dhënie amnistie” me zbritje dënimi me një vit e gjysmë nga dënimi i mbetur për personat burra, sipas nenit 5, pika 1, shkronja “b”, të këtij ligji.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 675-84, datë 03.07.2020, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit Geg Gega për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 79, shkronja “ë”, 22 dhe 278, paragrafi i parë, të Kodit Penal (*KP*) dhe, në aplikim të nenit 55 të *KP*-së, dënimin e tij me 11

vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 392, datë 15.09.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin, datë 16.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

2. Ndërkohë, me urdhrin e datës 22.11.2021, prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, pasi ka konstatuar se vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë pas përfundimit të gjykimit në gjykatën e apelit, ka urdhëruar që kërkuesi Geg Gega, pas datës 15.09.2021, duhet të vuajë dënimin e mbetur prej gjashtë vitesh dhe gjashtë muaj burgim, i cili do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3. Në datën 04.04.2024 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie” (ligji nr. 33/2024), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, datë 09.04.2024. Ky ligj ka për qëllim të përjashtojë nga vuajtja e dënimit dhe ndjekja penale, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret sipas dispozitave të këtij ligji (neni 1). Neni 3 i ligjit, në pikën 1, ka parashikuar përjashtimin nga vuajtja e dënimit, ndër të tjerë, të personave meshkuj; i) të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.03.2024, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi (shkronja “a”); ii) të dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 4 vjet (shkronja “c”); iii) të dënuar, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë bars ose mbi moshën 60 vjeç (shkronja “d”). Pika 2 e kësaj dispozite ka parashikuar rastet e mospërjashtimit nga vuajtja e dënimit, kurse neni 4 i ligjit ka përcaktuar kriteret ndaluese për përfitimin e amnistisë nga vuajtja e dënimit. Pika 1 e kësaj dispozite parashikon se, pavarësisht nga parashikimet e shkronjave “a”, “c” dhe “d” të nenit 3 të këtij ligji nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar, ndër të tjera, për krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 80, 81, 82, 83, 83/a, 83/b dhe 84/a të KP-së, si dhe në nenin 77 të KP-së Ushtarak (shkronja “b”).

4. Neni 5 i ligjit nr. 33/2024 përcakton kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit, duke parashikuar se të gjithë personave të dënuar, të cilët nuk plotësojnë kriteret për t’u përjashtuar nga vuajtja e dënimit, sipas nenit 3 të këtij ligji, ose, edhe pse plotësojnë kriteret për përfitimin e amnistisë sipas këtij neni, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit për shkak të kriterëve ndaluese të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji, u zbritet 1 vit e gjysmë nga dënimi i mbetur për personat e dënuar burra (shkronja “b”). Ndërkohë, pika 2 e kësaj dispozite, ndër të tjera, përcakton se, pavarësisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, nuk

përfitojnë zbritje të dënimit personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara në nenet 79, 79/a, 79/b dhe 79/c të KP-së (shkronja “a”).

5. Në datën 13.05.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, duke kërkuar përfitimin nga ligji nr. 33/2024, për rrjedhojë zbritjen me një vit e gjysmë nga dënimi i mbetur për të vuajtur prej tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

- 6.1. *Në kundërshtim me parimin e barazisë përpara ligjit*, sipas nenit 18 të Kushtetutës, neni 79 i KP-së është përjashtuar nga përfitimi i zbritjes së dënimit me një vit e gjysmë edhe pse, sipas nenit 2 të ligjit nr. 81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ata duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat e tyre. Edhe sipas nenit 1/c të KP-së të gjithë janë të barabartë përpara ligjit ndërkohë që parimi i zbatimit të ligjit në mënyrë të njëjtë për të gjithë parashikohet edhe nga ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (*ligji nr. 8331/1998*). Referuar nenit 6 të ligjit nr. 10295, datë 01.07.2010 “Për faljen”, që përcakton kriteret ndaluese për faljen e dënimit, neni 79 i KP-së nuk përfshihet te veprat penale të ndaluara. Falja bëhet nga Presidenti me propozim të ministrit të Drejtësisë, për rrjedhojë dy ligje të propozuara nga i njëjti institucion bien ndesh me Kushtetutën.
- 6.2. Në draftin e amnistisë nuk janë marrë parasysh parashikimet e mësipërme ligjore dhe as neni 64 i KP-së që parashikon lirin me kusht, i cili zbatohet edhe për veprën penale të parashikuar në nenin 79 të KP-së, ndërkohë që për këtë të fundit nuk zbatohet amnistia. Vepra penale e parashikuar nga neni 78/a i KP-së, pavarësisht se është një vepër penale më e rëndë se sa ajo e parashikuar në nenin 79, shkronja “ë”, të KP-së, përfiton nga ligji për amnistinë. Edhe pse për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i KP-së nuk përfitohet ulje e dënimit sipas ligjit nr. 33/2024, ai nuk ka parashikuar nëse zbatohet kur vepra penale ka qenë në tentativë, siç është rasti i kërkuesit. Juristi i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimit Penal (*IEVP*) e ka orientuar kërkuesin që t`i drejtohet gjykatës për interpretimin e ligjit në këtë aspekt. Kërkuesi i është drejtuar ministrit të Drejtësisë dhe Presidentit,

por nuk ka marrë përgjigje, kurse te gjykatat e zakonshme ai nuk ka besim për shkak të kualifikimit që ato i kanë bërë akuzës së ngritur ndaj tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kjo dispozitë kushtetuese është zbrërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a).

8. Bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në jurisprudencën kushtetuese është vlerësuar se në këto raste kërkuari legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: (i) legjitimitimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimitimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimitimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kolegji vëren se kërkuari, edhe pse në objekt të ankimit kushtetues individual ka kërkuar zbatimin e amnistisë sipas ligjit nr. 33/2024, pra të uljes së masës së mbetur për të vuajtur në dënimin e dhënë ndaj tij me vendim penal të formës së prerë, në thelb pretendimet e tij lidhen me mosrespektimin e parimit të barazisë përpara ligjit për shkak të kriterit ndalues

që parashikon ligji nr. 33/2024 për personat e dënuar, ndër të tjera, për veprën penale të parashikuar në nenin 79 të KP-së. Bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vërehet se kërkuesi është dënuar nga gjykatat për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “ë”, i KP-së, i cili nuk përjashtohet nga vuajtja ose zbritja e dënimit sipas nenit 4, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 5, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 33/2024. Për rrjedhojë, ligji nr. 33/2024, që përcakton në mënyrë shteruese kriteret ndaluese për përfitimin e amnistisë, duke mos ngarkuar asnjë organ për nxjerrjen e akteve nënligjore, është drejtpërdrejt i zbatueshëm edhe ndaj kërkuesit, për rrjedhojë ai legjitimohet *ratione personae* për t’iu drejtuar Gjykatës, pasi provon interesin e drejtpërdrejtë për çështjen e ngritur.

10. Për sa i përket *kriterit të shterimit të mjeteve juridike*, ai nënkupton jo vetëm ekzistencën e një mjeti juridik në dispozicion të kërkuesit, por edhe efektivitetin e këtij mjeti në drejtim të përshtatshmërisë së tij për mbrojtjen thelbësore të së drejtës kushtetuese që kërkuesi pretendon se i është cenuar. Megjithëse natyra e mjetit juridik mund të jetë e ndryshme në varësi të natyrës së ankimit të kërkuesit, efektiviteti i tij vlerësohet jo vetëm nga parashikimi ligjor, por edhe nga rezultati i zbatimit të ligjit. Nenet 470-480 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe ligji nr. 8331/1998 parashikojnë procedurën e shqyrtimit nga gjykata të çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale dhe të drejtën e të dënuarit për të paraqitur kërkesë në gjykatën e vendit të ekzekutimit, duke përfshirë edhe kërkesën për shuarjen e dënimit penal nga ligji për dhënie amnistie. Sipas nenit 471, pika 2, të KPP-së, kur kërkesa është haptazi e pabazuar gjykata e deklaron atë të papranueshme me vendim, ndaj të cilit mund të bëhet ankim. Në vlerësimin e Kolegjit, ky mjet juridik nuk i ofron premisa suksesi kërkuesit, për sa kohë që përmbajtja e nenit 4 të ligjit nr. 33/2024 ka përcaktuar në mënyrë të shprehur dhe shteruese veprat penale që nuk përfitojnë nga amnistia e dënimit, ku përfshihet edhe rasti i tij. Për rrjedhojë, për sa kohë që nuk evidentohet ndonjë mjet juridik efektiv në dispozicion të kërkuesit që mund t’i ofrojë atij ndonjë premisë suksesi në drejtim të rivendosjes së të drejtës të pretenduar të cenuar, konkretisht paraqitja e kërkesës në rrugë administrative në administratën e IEVP-së dhe më pas kërkesa në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji vlerëson se kërkuesi e ka plotësuar edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, nenet 71/a, pika 1, shkronja “b” dhe 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë se në rastin e ankimit kushtetues individual, afati për paraqitjen e kërkesës për papajtueshmërinë e ligjit ose të ndonjë akti tjetër normativ me Kushtetutën është 4 muaj nga konstatimi i cenimit. Duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi nuk ka mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara të

cenuara, afati për paraqitjen e kërkesës konsiderohet ai i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 33/2024, që është data 24.04.2024. Kërkesa është dërguar në Gjykatë, përmes shërbimit postar, në datën 13.05.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se kriteri ndalues për mospërfitimin nga amnistia në zbritjen e dënimit të personave të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i KP-së, bie ndesh me parimin e barazisë përpara ligjit, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, i cili, sipas tij, ka gjetur shprehje dhe zbatim edhe në akte të tjera ligjore të zbatueshme në fushën penale.

13. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore (*shih vendimet nr.10, datë 29.02.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk dikton zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme, por ajo nënkupton kryesisht barazinë e individëve që ndodhen në kushte të njëjta (*shih vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Pika 3 e nenit 18 mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte dhe sipas saj askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në pikën 2 të këtij neni nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive (*shih vendimet nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur edhe për kuptimin kushtetues e ligjor të amnistisë, e cila përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe ose dënimeve përkatëse. Amnistia e veprës penale vepron përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit, me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer, ndërsa amnistia e dënimit ndërhyt pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit dhe të dënimeve plotësuese, edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndërsa amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm (*shih vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 16, datë 19.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji vlerëson se në parim amnistia nuk përbën një të drejtë subjektive, e cila mund të kërkohe dhe të mbrohet gjyqësisht, sepse është një akt mëshire që jepet nga Kuvendi sipas diskrecionit ekskluziv të tij dhe që përjashtimisht ndërhyt në kompetencat e pushtetit gjyqësor në dhënien e drejtësisë penale. Diskrecioni i Kuvendit në dhënien e amnistisë lidhet

me faktin se ushtrimi i ndjekjes penale është funksion ekskluziv shtetëror që mbron jo vetëm viktimitë e një vepre penale konkrete, por edhe interesin e gjerë publik për rend dhe siguri.

16. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se ligji nr. 33/2024 ka përjashtuar, veç të tjerash, nga vuajtja e dënimit ata persona që plotësojnë kriteret e përcaktuara prej tij, që bazohen në masën e ulët të dënimit ose kohën e mbetur pa vuajtur të dënimit, apo veçori të tilla si gjinia dhe mosha. Këto dy grupe kriteresh janë tregues të rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarve që përfitojnë nga amnistia, duke justifikuar zbatimin e drejtpërdrejtë të parimit të humanizmit. Ndërsa kriteret ndaluese të përfitimit të amnistisë janë tregues të rrezikshmërisë së lartë shoqërore, që prekin interesin publik për rend dhe siguri. Në vlerësimin e Kolegjit, përcaktimi i kriterëve përfituese ose ndaluese në ligjin për amnistinë është, gjithashtu, në diskrecion të Kuvendit që vepron në reflektim të politikave penale të shtetit.

17. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë, në kuptim të parimit të barazisë përpara ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës, se kriteri ndalues për personat që janë dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i KP-së është zbatuar në mënyrë të ndryshme ndaj personave të tjerë të dënuar për shkak të veçorive dalluese të tyre si mosha ose gjinia. Në këto kushte, për sa kohë që nuk është provuar se ka pasur një trajtim ndryshe nga ligjvënësi ndaj personave që i përkasin kategorive të njëjta me kërkuesin, pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.